

Kravata femërore është një aksesor absolutisht i veçantë. Kravata konsiderohet pjesë e garderobës së mashkullit dhe u desh kohë deri sa femrat të fillonin ta përdornin këtë detaj për vete. Fillimisht femrat ndihmonin meshkujt të lidhin kravatat, kur ata gjendeshin në vështirësi dhe vetëm pas kalimit të kohës ato e panë kravatën si një aksesor të çmuar për imazhin e tyre.

Femra e parë që lidhi në qafën e vet kravatë ka qënë dukeshja Luiza de Lavalier, e cila ishte e preferuara e Mbretit Louis XIV të madh. Ishte pikërisht Lavalier që mendoi një model të pazakontë të lidhjes së kravatës, prej nga edhe modeli mori emrin në nder të saj "Lavalier".

Çfarë duhet të kesh parasysh në përzgjedhjen e kravatës?

Kravata femërore mund të jetë njëngjyrëshe, me vizë, apo me figura dhe ngjyra të ndryshme. Ndërsa kravatat tepër rinore janë madje me personazhe të filmave vizatimorë të famshëm dhe me figura interesante.

Pamje origjinale kanë edhe kravatat me motive apo ato me qëndisje. Prandaj, kur e blen një kravatë kij parasysh me çfarë do ta kombinosh atë në garderobën tënde, që të bësh kujdes në zgjedhjen e modelit, ngjyrës dhe stilit të saj.

Copa e kravatës

Kravata femërore tërheq shumë vëmendjen, prandaj cilësia e saj është shumë e rëndësishme. Zgjedhje të shkëlqyera do të ishin materiale të tilla si: atlas, pambuk, mëndafsh dhe viskozë.



Gjatësia dhe gjerësia e kravatës femërore

Përsa i përket gjatësisë, kravata femërore zakonisht nuk arrin deri në linjën e belit.

Femrat nuk e mbajnë kravatën njësoj si meshkujt. Megjithatë kravata mund ti merret hua edhe një miku, ajo para së gjithash duhet të kthehet në një aksesor të vërtetë femëror.

Gjëja e parë që duhet pasur parasysh është gjatësia, që në rastin e femrave është zakonisht sa gjysma e kravatave të meshkujve apo një herë e gjysmë më e shkurtër se gjatësia normale e kravatave të meshkujve.



Me çfarë kombinohet dhe vishet kravata?

Një femër e veshur me kravatë është misterioze dhe tërheqëse në sy të mashkullit, prandaj edhe femrat e kanë shndërruar kravatën në aksesori të tyre. Nga na tjetër ky detaj është një element shqetësues për botëkuptimin dhe egoizmin mashkullor. Me këtë stil dalin në pah njëkohësisht feminiteti dhe forca maskiliste e pakompromistë e femrës, flirtimi prej kokete dhe karakteri i fortë, të cilat së bashku japin një efekt të mrekullueshëm të kombinimit të seksualitetit dhe vetpërbajtjes së maturisë, pasi kravata është një lloj atribut formaliteti që nuk lejon të dalë situata nga kontrolli.

Personat kreativë gjithashtu mund ta mbajnë kravatën në format dhe kombinimet më të çuditshme, duke krijuar stil të veçantë dhe tepër origjinal.



Vajzat e reja, mund të shtojnë siluetës së tyre elemente pikante dhe ekstrevagante duke kombinuar minifundin me një kravatë të shkurtër apo të gjatë mbi këmbë serioze. Një femër e tillë është më e vërtetë e paparashikueshme në sytë e mashkullit.

Dhe nuk është e vërtetë kur thuhet se femrat imitojnë meshkujt kur veshin kravatë. Për meshkujt kravata përforcon imazhin e njeriut serioz dhe simbolizon formalitetin, ndërsa për femrën është e kundërta - tregon eksocentrizëm, lojë.



Së fundmi, çfarë është e rëndësishme në modën e kravatave?

Është respektimi i kufijve midis asaj që ndan veshjen tërheqëse nga habia e shijes absurde.

Pjesa tjetër mbetet në fantazinë e femrave dhe dëshirën për te eksperimentuar.